

Vendim nr. 175 datë 13.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 13.07.2023 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 6 (H) 2023 të Regjistrit Themeltar që i përket:

KËRKUES: HAXHI KONESHA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 2750 (86-2018-3083), datë 06.07.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2022-2396, datë 27.10.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 11, pika 2, 15, 17, 18, 41, 42, 44, 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “f”, si dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Haxhi Konesha (*kërkuesi*) është pronar i një objekti në rrugën “Qemal Stafa”, Tiranë, në të cilin ka ndërtuar pa leje një shtesë objekti, me sipërfaqe 95 m². Bazuar në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar (*ligji nr. 9482/2006*), ai e ka deklaruar këtë shtesë në Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale (*ALUZNI*).

2. Gjatë kontrollit të datës 29.09.2014 të ushtruar nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (*INUK*) është konstatuar se kërkuesi ka ndërtuar shtesën e objektit në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, për të cilën INUK-u ka mbajtur procesverbal për konstatimin e kundërvajtjes nr. 0000511, datë 29.09.2014. Bazuar në këtë procesverbal, ky institucion ka nxjerrë vendimin nr. 10, datë 30.09.2014 për prishjen e objektit të kundërligjshëm, duke vijuar me ekzekutimin e tij dhe prishjen e shtesës së ndërtuar pa leje.

3. Për sa më lart, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi, duke kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga prishja e shtesës së objektit dhe fitimin e munguar, bazuar në nenin 44 të Kushtetutës dhe ligjin nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”, me pretendimin se veprimi i INUK-ut është në kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën, pasi ai nuk është njohur më parë me aktin për konstatimin e kundërvajtjes, për rrjedhojë nuk ka mundur të japë shpjegime dhe të paraqesë dokumente. Kërkuesi ka pretenduar se ndërtimin e këtij objekti e ka vetëdeklaruar tek ALUIZNI për të vijuar me procedurat e legalizimit, bazuar në ligjin nr. 9482/2006 dhe sipas VKM-së nr. 900, datë 12.12.2012 “Për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale” (*VKM nr. 900/2012*), emri i kërkuesit ishte në listën bashkëngjitur saj.

4. Me vendimin nr. 2652, datë 18.05.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, detyrimin e INUK-ut të dëmshpërblejë kërkuesin në shumën 4,022,248.8 lekë dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër. Ajo ka arsyetuar se veprimet e INUK-ut janë në shkelje të ligjit që normon veprimtarinë e tij, objekti i ndërtuar pa leje nuk ndodhet në zona me rëndësi kombëtare dhe ai, gjithashtu, ndodhej në proces legalizimi që prej vitit 2006. INUK-u, bazuar në nenin 10/1, pika 2, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” (*ligji nr. 9780/2007*), kishte detyrimin ligjor të kërkonte dokumentacion nga zyra e urbanistikës ose nga ALUIZNI, detyrim të cilin nuk e ka respektuar, si dhe të njoftonte subjektin e kontrolluar për procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes brenda 5 ditëve nga data

e kontrollit, ndërkohë që nuk rezulton që ai të jetë nënshkruar nga kërkuesi, por në të citohet se është lënë në objekt. Po sipas gjykatës, brenda 10 ditëve nga komunikimi i këtij procesverbali, INUK-u duhet të nxirrte vendimin për prishjen e objektit. Gjykata ka evidentuar se procesverbali i konstatimit të kundërvajtjes mban datën 29.09.2014, ndërsa vendimi për prishjen e objektit mban datën 30.09.2014, pra vendimi për prishjen e shtesës së objektit është marrë një ditë më pas. Mosrespektimi i këtyre procedurave ligjore ka bërë që pala e paditur të mos marrë informacionin e duhur për të provuar ligjshmërinë e shtesës së pallatit të ndërtuar nga paditësi, duke i mohuar në këtë mënyrë të drejtën për të paraqitur dokumentacion për shtesën e pallatit të ndërtuar pa leje, si dhe të drejtën të japë shpjegime në lidhje me të. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim Avokatura e Shtetit dhe INUK-u.

5. Me vendimin nr. 2750, datë 06.07.2018, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes, duke arsyetuar se veprimet e INUK-ut për prishjen e objektit rezultojnë të jenë kryer në zbatim të aktit administrativ të tij, vendimit nr. 10, datë 30.09.2014, i cili bazohet në kuadrin ligjor në fuqi, në momentin e disponimit të tij, konkretisht në nenin 14 të ligjit nr. 9780/2007. Po sipas gjykatës, bazuar në këto dispozita, kundër aktit administrativ të INUK-ut lejohet ankimi administrativ dhe gjyqësor dhe në rast se me vendim përfundimtar të formës së prerë të gjykatës vendoset pranimi i padisë, i dëmtuari më pas ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar. Rrjedhimisht, në kohën e ngritjes së padisë për shpërblim dëmi nga kërkuesi, konfirmohet kushti i ngritjes së kësaj padie vetëm pas zgjidhjes me vendim gjyqësor të formës së prerë të (pa)ligjshmërisë së vendimit të INUK-ut. Paditësi e ka investuar gjykatën pa e zgjidhur paraprakisht në rrugë gjyqësore çështjen e ligjshmërisë së këtij akti administrativ, duke kërkuar dëmshpërblim për prishjen e shtesës së objektit. Për rrjedhojë, për sa i takon situatës faktike në kohën e ngritjes së padisë, praktika e shembjes së shtesës së objektit është e mbyllur me vendim administrativ të paankimuar në gjykatë mbi ligjshmërinë e tij. Gjykata ka çmuar se ndodhet në kushtet e shqyrtimit të një padie, gjykimi i së cilës, për shkak të mosshqyrtimit në rrugë gjyqësore dhe me vendim të formës së prerë të ligjshmërisë së aktit administrativ, vendimit nr. 10, datë 30.09.2014 të INUK-ut, nuk mund të vazhdojë. Kundër vendimit të gjykatës së apelit kërkuesi ka ushtruar rekurs.

6. Me vendimin nr. 00-2022-2396, datë 27.10.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se është bërë për

shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit. Sipas tij, në juridiksionin rishikues të Gjykatës së Lartë përfshihen vetëm rastet rigorozisht të përcaktuara në këtë dispozitë, që lidhen me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit të një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, si dhe me shkeljet e rënda të normave procedurale apo shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Në çështjen objekt gjykimi nuk rezulton të jenë ngritur shkaqe të tilla, pasi pretendimet e ngritura në rekurs ngrenë çështje të vlerësimit të provave, të cilat janë jashtë juridiksionit ligjor të Gjykatës së Lartë.

7. Në datën 23.05.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuetit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblëdhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

8.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1.1. *Së drejtës për t’u dëgjuar*, pasi konstatimi i ndërtimit të godinës pa leje dhe prishja e saj nga INUK-u janë kryer në mënyrë të menjëhershme, duke i mohuar të drejtën për të dhënë shpjegime dhe paraqitur dokumente, në kushtet kur ndërtimin e shtesës së objektit ai e ka deklaruar tek ALUIZNI për procedurat e legalizimit, bazuar në ligjin nr. 9482/2006 dhe emri i tij është në listën bashkëngjitur VKM-së nr. 900/2012.

8.1.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë e kanë shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për datën dhe orën e gjyimit të çështjes.

8.1.3. *Së drejtës për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm*, pasi vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë janë marrë tej afateve kohore ligjore.

8.2. *E drejta për dëmshpërblim*, pasi kjo e drejtë, përveç mbrojtjes me ligj të veçantë, siç është ligji nr. 8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve

të administratës shtetërore”, gëzon dhe mbrojtje kushtetuese, konkretisht në nenin 44 të saj.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

10. Kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin administrativ dhe atë gjyqësor në përfundim të të cilit janë dhënë vendimet e kundërshtuara, duke provuar interesin e tij të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda afatit të arsyeshëm, pasi vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë janë marrë tej afateve kohore ligjore. Në lidhje me këtë pretendim, nga materialet e depozituara së bashku me kërkesën, nuk rezulton që gjatë gjykimit të çështjes së tij nga këto gjykata, kërkuesi t'u jetë drejtuar atyre me kërkesë për konstatimin e cenimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, sipas neneve 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (KPC), duke mos arritur të provojë në këtë mënyrë mungesën e efektivitetit të këtyre mjeteve ligjore për mbrojtjen e së drejtës së tij për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, si një aspekt i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet për sa i përket këtij pretendimi, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000.

13. Lidhur me pretendimet e tjera, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë dhe pas përfundimit të procesit gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit të zakonshëm, ku vendimi i fundit që ai kundërshton është ai i Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

14. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 23.05.2023, ndërsa vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, është i datës 27.10.2022. Nga dokumentacioni i paraqitur për efekt të gjykimit kushtetues së bashku me kërkesën, rezulton se kërkuesi është vënë në dijeni për këtë vendim nëpërmjet shkresës nr. 2589/1, datë 16.05.2023 të Gjykatës së Lartë, duke u pajisur njëkohësisht edhe me një kopje të tij. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

15. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, kërkuesi pretendon se i janë cenuar e drejta për t'u dëgjuar, e drejta e aksesit, edhe e drejta për dëmshpërblim. Kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur.

16. Sa i përket cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar nga organi publik, INUK-u, kërkuesi ka pretenduar se konstatimi i ndërtimit të shtesës së objektit pa leje dhe prishja e saj janë kryer në

mënyrë të menjëhershme, duke i mohuar të drejtën për të dhënë shpjegime dhe paraqitur dokumente në lidhje me faktin se ndërtimin e ka deklaruar tek ALUIZNI, për të vijuar me procedurat e legalizimit, bazuar në ligjin nr. 9482/2006 dhe se emri i tij është në listën bashkëngjitur VKM-së nr. 900/2012. Për sa i përket këtij pretendimi, vlerësohet se ai nuk është ngritur në nivel kushtetues, pasi konstatohet se kërkuesi e ka parashtruar atë përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, të cilat i kanë dhënë përgjigje të argumentuar në lidhje me të, duke vlerësuar se në rrethanat kur (pa) ligjshmëria e aktit administrativ, vendimit nr. 10, datë 30.09.2014 të INUK-ut, nuk është bërë objekt shqyrtimi nga gjykatat e sistemit të zakonshëm, elementet e këtij akti, që kanë sjellë për pasojë prishjen e objektit informal në proces legalizimi, nuk mund të viheshin në diskutim në padinë me objekt shpërblim dëmi dhe fitim të munguar.

17. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës për dëmshpërblim, të parashikuar nga neni 44 i Kushtetutës, si rrjedhojë e prishjes së shtesës së objektit të ndërtuar pa leje, në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se e drejta kushtetuese për t'u rehabilituar dhe/ose zhdëmtuar ka si parakusht logjik dhe juridik të saj paligjshmërinë e veprimit dhe mosveprimit të organeve shtetërore (*shih vendimin nr. 32, datë 27.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Për të përcaktuar nëse kërkuesit i është cenuar kjo e drejtë, është e rëndësishme të analizohet nëse procesi ligjor i zhvilluar nga gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë ka vendosur përfundimisht për të drejtën e tij për dëmshpërblim.

18. Në analizë të vendimmarrjes së gjykatave, rezulton se prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, sa i përket situatës ligjore të prishjes së shtesës së objektit, Gjykata Administrative e Apelit e ka vlerësuar në zbatim të aktit administrativ të vendimit nr. 10 datë 30.09.2014 të INUK-ut. Sipas arsytimit të saj: *“Vendimi rezulton të ketë reflektuar kuadrin ligjor në fuqi në momentin e disponimit të tij, konkretisht dispozitat e ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”. Në nenin 14 të ligjit parashikohet se “Kundër vendimit të INUK të bashkisë/komunës/qarkut për marrjen e masave dhe dhënien e sanksioneve administrative lejohet ankimi administrativ dhe gjyqësor, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi. Ankimi administrativ dhe gjyqësor kundër vendimit të inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut nuk pezullon ekzekutimin e tij. Kundër vendimeve të INUK-ut, lejohet ankim i drejtpërdrejtë në gjykatë brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit. Në rast se, me vendimin përfundimtar të formës së prerë të gjykatës, vendoset pranimi i padisë, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë nga inspektorati ndërtimor*

e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut/kombëtar që ka dhënë vendimin, dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar”.

19. Për sa më lart, konstatohet se gjykata e apelit ka trajtuar në mënyrë të plotë në vendimin e saj se kundërshtimi i aktit administrativ për (pa)ligjshmërinë e tij përbën parakusht thelbësor për të kërkuar më pas dëmshpërblim. Detyrimi i organit administrativ për dëmshpërblim lind pasi nga gjykata me vendim të formës së prerë është konstatuar paligjshmëria e aktit që ka sjellë pasojën.

20. Në lidhje me rekursin, Kolegji vëren se pretendimet e ngritura nga kërkuesi janë marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila ka vlerësuar se në juridiksionin rishikues të Gjykatës së Lartë përfshihen vetëm rastet rigorozisht të përcaktuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit, që lidhen me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit të një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, si dhe me shkeljet e rënda të normave procedurale apo shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Në çështjen objekt gjykimi, nuk rezulton të jenë ngritur shkaqe të tilla pasi pretendimet e ngritura në rekurs, ngrenë çështje të vlerësimit të provave të cilat janë jashtë juridiksionit ligjor të Gjykatës së Lartë.

21. Në jurisprudencë të konsoliduar kushtetuese është theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, si dhe interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Megjithatë, Gjykata ndërhyr në ato raste kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 5, datë 01.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Bazuar në këto standarde, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të natyrës ligjore, pra me mënyrën e zbatimit të ligjit dhe të interpretimit të tij nga gjykatat e zakonshme, si dhe të vlerësimit e shqyrtimit të provave, të cilat për nga natyra dalin jashtë juridiksionit kushtetues dhe nuk rezultojnë të jenë shoqëruar me shkelje të nivelit kushtetues. Në këto kushte edhe ky pretendim i kërkuesit vlerësohet jo i ngritur në nivel kushtetues, për rrjedhojë nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

23. Në ankimin kushtetuese individual kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, edhe cenimin e se drejtës së aksesit. Ky pretendim i tij *prima facie* bën pjesë në juridiksionin kushtetues ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit

24. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi, gjithashtu Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për datën dhe orën e gjyqimit të çështjes.

25. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për proces të rregullt ligjor, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se e drejta e aksesit në gjykatë nuk mund t'i cenohet kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 5, datë 02.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Për sa i përket zhvillimit të procesit në dhomë këshillimi nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ndryshimet e bëra në ligjin nr. 49/2012, konkretisht në nenet 49, pika 1 dhe 61, pika 1, të tij, e kanë kthyer në rregull gjykimin në dhomë këshillimi në Gjykatën Administrative të Apelit dhe Gjykatën e Lartë. Vetëm në raste të veçanta, për shkaqe të mirëpërcaktuara në ligj, ato vendosin kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Në çështjen konkrete nuk ka ekzistuar asnjë prej rasteve të parashikuara në nenet 51 dhe 62 të ligjit nr. 49/2012 për shqyrtimin e çështjes nga këto gjykata në seancë gjyqësore me

praninë e palëve. Po kështu, sipas ndryshimeve të bëra në nenet 49, pika 2 dhe 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, njoftimi për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë, bëhet me shpallje. Në këto kushte, pretendimi i kërkuarit lidhur me pjesëmarrjen e palëve në proceset e zhvilluara përpara këtyre gjykatave në mungesë, është haptazi i pabazuar.

27. Po kështu, sipas nenit 482 të KPC-së, për gjykimin në Gjykatën e Lartë, sekretaria e gjykatës shpall listat për shqyrtimin e rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit. Njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë dhe me njoftim individual, kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit të paktën 15 ditë përpara, kur palët kanë adresë elektronike të deklaruar ose të njohura.

28. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nga rekursi i paraqitur dhe nënshkruar nga kërkuari dhe mbrojtja e tij. Referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “Kalendari i çështjeve”, konstatohet se në datën 22.09.2022 gjykata ka bërë shpalljen për gjykimin e çështjes së kërkuarit. Gjithashtu, në datën 27.10.2022 rezulton se vendimmarrja e Kolegjit Administrativ që ka gjykuar çështjen, është publikuar në faqen elektronike të kësaj gjykate sipas parashikimeve ligjore. Nga sa më lart, kërkuari ka detyrimin të ndjekë vetë fatin e çështjes së tij dhe argumenti se nuk i është komunikuar informacioni për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes, është i pamjaftueshëm për të mbështetur pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u njoftuar në drejtim të së drejtës së aksesit.

29. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit është haptazi i pabazuar.

30. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.